



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016 Ref.: 639/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:
 - Edukim i përgjithshëm në muzikë, BA Profesional, 240 ECTS, (maksimum 20 studentë për vit akademik);
 - Edukim në muzikë, BA Profesional, 240 ECTS, (maksimum 20 studentë për vit akademik);
- II. Nuk riakreditohet programi i studimit:
 - Menaxhim i burimeve njerëzore, MSc, 120 ECTS.
- III. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.
- IV. Obligohet Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm te stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- V. Obligohet Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

A r s y e t i m i

Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Edukim i përgjithshëm në muzikë	BA	240	Astrit Pallaska, Syzana Jakupi, Bardha Gashi
2	Edukim në muzikë	BA	240	Mimoza Pajaziti, Hysen Nimani, Fatbardh Gashi
3	Menaxhim i burimeve njerëzore	MSc	120	Ibish Mazreku, Halit Shabani, Edmond Beqiri

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin e Pejës “Haxhi Zeka” më 06.06.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Ms. Doris Carstensen, Ms. Bettina Henkel, Prof. Dr. Dietmar Paier.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2016 ka vlerësuar aplikacionin e Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Menaxhim i Burimeve Njerëzore, MSc, 120 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Ekspertët kanë thënë se shumica e rekomandimeve të Raportit të Ekspertëve të dhëna në vitin 2013 nuk janë plotësuar mjaftueshëm. Sipas ekspertëve, mangësi serioze kanë mbetur ende edhe në aplikacionin e këtij viti. Universiteti i Pejës nuk ka plotësuar rekomandimet e dhëna në vlerësimin e mëhershëm në lidhje me statusin dhe ndryshimin e disa lëndëve në kurrikulë. Sipas ekspertëve programi i studimit ka për qëllim që të kombinojë studimet akademike me trajnime praktike megjithatë asnjë referencë në lidhje me arritjen e qëllimit për trajnim praktik nuk është bërë dhe nuk është dhënë në RVV e as në syllabuse. Ekspertët kanë thënë se cilësia e përgjithshme e programit të studimit në kuptim të përmbajtjeve mësimore dhe lëndëve të ofruara në kurrikulë nuk janë plotësisht të përshtatshme me gradën akademike. Po ashtu për shkak të pjesëve të paplota dhe gabimeve në përshkrimet e lëndëve, ekspertët nuk kanë mundur të vlerësojnë këto kriterë mirë. Sipas ekspertëve, kalkulimi i ECTS-së nuk është i përshtatshëm dhe i arsyetuar mirë. Kalkulimi i ECTS-ve që është element kyç për çdo program të studimit dhe i cili ka

për synim që të korrespondojë me standardet ndërkombëtare nuk është përmbushur nga Universiteti.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë